

VENDIM
Nr. 73, datë 1.10.2018

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT PËR NDRYSHIM
TARIFE TË SHOQËRISË SË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE VLORË**

Në mbështetje të neneve 13, 14, 21 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102); të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015, “Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 40); të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015, “Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 41); të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015, “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimin e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 42), Komisioni Kombëtar Rregullator, në mbledhjen e datës 1.10.2018, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike mbi kërkesën e Ujësijellës-Kanalizimeve Vlorë sh.a., për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime,

konstatoi se:

Shoqëria Ujësijellës-Kanalizimeve Vlorë është licencuar me vendimin e KKRR-së nr. 10, datë 21.3.2017, “Për licencimin e Ujësijellës-Kanalizimeve Vlorë” pas përfundimit të riorganizimit sipas ndarjes së re territoriale, bazuar në pikën 3, të kreut II, të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”.

Shoqëria e Ujësijellës-Kanalizimeve Vlorë ka aplikuar pranë ERRU-së, me shkresën nr. 666 prot., datë 28.6.2018, me lëndë “Kërkesë për nivel të ri tarife (*unifikim tarife në të gjithë zonën e shërbimit*) për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin (kanalizime) e ujërave të ndotura”, bazuar në vlerësimin e situatës ekonomike-financiare dhe nevojën për përmirësimin e saj pas riorganizimit sipas reformës administrativo-territoriale.

Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria UK Vlorë kishte pasaktësi në dokumentin “Modeli i aplikimit”, i cili nuk ishte plotësuar sipas standardit të caktuar nga ERRU-ja.

ERRU-ja iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 334/3 prot., datë 20.7.2018, për plotësim të dokumentacionit të mësipërm.

Shoqëria UK Vlorë, në datën 26.9.2018, ka dërguar elektronikisht plotësimet e nevojshme në dokumentacionin e munguar sipas standardit të kërkuar nga ERRU-ja.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i shoqërisë UK Vlorë, është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në vendimin nr. 40 dhe kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë së Ujësijellës-Kanalizimeve Vlorë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime.

2. Drejtoria Tekniko-Ekonomike detyrohet të njoftojë shoqërinë e Ujësijellës-Kanalizimeve Vlorë për vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ndriçim Shani